

26. T'u bërë më shumë për t'i hequr gratë dhe femijët nga varfëria. Më pak se 10 përqind e popullsisë së botës jeton ende në varfëri ekstreme, por ndikimi i saj shpesh është shkatërrues.

27. Gratë që të kuptojnë se Perëndia i krijoi ato në imazhin e tij dhe për t'i sjellë lavdi Atij. "Kështu Perëndia krijoi njeriun simbas shëmbëlltyrës së vet, simbas shëmbëlltyrës së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin e femrën." (Zanafilla 1:27).

28. Gratë që të jenë të gatshme të ndryshojnë prioritetet e tyre dhe çdo gjë tjetër që i pengon ato të ndjekin vullnetin e Perëndisë. "O Zot, më trego rrugët e tua, më mëso shtigjet e tua. Më udhëhiq në të vërtetën tënde dhe më mëso, sepse ti je Perëndia i shpëtimit tim; unë shpresoj shumë te ti gjatë gjithë ditës." (Ps 25: 4-5).

29. Ata që vizitojnë vejjat në Shqipëri, Kamboxhia, Indi, Kenia, Tanzani dhe vende të tjera, dhe ata që i ndihojnë këto gra të fillojnë bizneset e vogla në mënyrë që të fitojnë para për të mbështetur familjet e tyre.

30. Udhëheqësit dhe prindërit për t'u siguruar vajzave një edukim që i pajis ato me njohurinë, aftësitë dhe konfidencën e nevojshme për të siguruar për familjet e tyre.

31. T'u bërë më shumë në ndalimin e dhunës ndaj grave dhe për të mbrojtur gratë kundër infeksioneve me HIV. Në vitin 2017, rreth 6,600 gra nga moshat 15 dhe 24 vjeç u infektuan me HIV çdo javë.

Dëgjoni programin "Shpresë për ty" në:

Radio 7: 97,7 FM: të shtunën ora 8:30

Radio Emanuel: 95,7 FM të shtunë ora 9:00

Radio Logos: 94,2 FM të shtunë/ të dielë ora 9:00 dhe 17:00

8 Mars, Dita Ndërkombëtare e Grave, është një kohë për të pranuar atë që është arritur nga dhe për gratë. Ka pasur shumë zhvillime në arsim, burime mjekësore dhe në cilësinë e jetës për gratë që jetojnë në varfëri ose në izolim nga kulturat dhe fetë. Perëndia përdor skuadrat e Shpresë për ty nga TWR në mbarë botën për të përmirësuar jetën e grave.

Për 21 vjet, dhjetëra mijëra ndërmjetësues të "Shpresë për ty" kanë promovuar dhe janë lutur për ndërgjegjësim anembanë të abuzimeve, sëmundjeve, varfërisë dhe neglizhimit me të cilin gratë dhe vajzat përballen. Ky ndërgjegjësim ka bërë që komunitetet, familjet dhe të krishterët midis tyre t'i shohin ndryshe viktimat dhe të jenë të gatshëm të kërkojnë mënyra për të ndihmuar dhe për të folur për ata që nuk kanë zë.

Shumë skuadra të "Shpresë për ty" nga TWR japin dhurata si ushqim, veshje dhe artikuj të tjerë për ato që janë në nevojë, duke i inkurajuar ato dhe duke u treguar respekt. Në Tanzani, këto ekipe punojnë ngushtë me organizata të tjera të krishtera për të mësuar rrugët për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore dhe rrethprerjes femërore. Në Nepal, gratë në fshatrat e largëta marrin informacionin jetëndryshues të kujdesit shëndetësor: në Shqipëri, grave rome në varfëri dhe grave që kanë qenë në strehëzat e dhunës në familje u tregohet për dashurinë e Jezusit dhe sa shumë Zoti i çmon ato.

Mëkati, grindjet dhe padrejtësitë gjithmonë do të punojnë për të shkatërruar jetë. Vazhdoni të luteni që shumë besimtarë do të zbulojnë më shumë nga Perëndia, do të kuptojnë se kush janë në Krishtin dhe do të lejojnë që Shpirti i Shenjtë të punojë përmes tyre, duke folur dhe duke mbrojtur gratë dhe vajzat ndërkohë që i ndihmojnë ato të përparojnë.



Të bashkojmë zemrat në lutje



Programi "Shpresë për ty" transmetohet në 73 gjuhë
Kërkesat mujore të lutjes përdoren në 100 gjuhë
Dëgjoni kalendarin e lutjes online në: twr-albania.com

Të lutemi për ...

1. Njerëzit që janë mbledhur rreth e rrotull globit sot në Ditën Botërore të Lutjes për të zbuluar më shumë rreth Perëndinë dhe për të kuptuar se kush janë në Krishtin ndërsa përpiqen të jetojnë për t'i sjellë lavdi Perëndisë.

2. Gratë, të dinë se ato janë të dashura nga Perëndia krijuesi i tyre. Lutuni që ato do të zgjedhin të pranojnë dhuratën e shpëtimit të Perëndisë nëpërmjet Jezu Krishtit dhe t'i shërbejnë atij duke ndihmuar të tjerët në nevojë.

3. Ato gra, mjediset e kulturore dhe fetare të të cilave i pengojnë ato të dëgjojnë për dashurinë e Perëndisë dhe shpresën që mund të kenë nëpërmjet Jezu Krishtit. Shumë prej tyre dëgjojnë me guxim në shtëpitë e tyre programet e radiove të krishtera të ndaluara në vendin e tyre.

4. Gratë që luftojnë me varfërinë, problemet familjare, trazirat e komunitetit ose barrierat kulturore. "Jini të gëzuar në shpresë, të qëndrueshëm në shtrëngime, këmbëngulës në lutje" (Romakëve 12:12).

5. Skuadrat e prodhimit "Shpresë për ty", ndërkohë që ofrojnë programe në 73 gjuhë te botës. Lutuni për gratë që japin udhëzime të mëtejshme për të jetuar një jetë si Krishti nën rrethana jashtëzakonisht të vështira.

6. Ata që luten me ne. "Edhe për këtë ne vazhdimisht po lutemi për ju, që Perëndia ynë t'ju bëjë të denjë për këtë thirrje dhe të përmbushë me fuqinë çdo qëllim të mirë dhe veprën e besimit" (2 Thesalonikasve 1: 11).

7. Gratë të luten rregullisht, duke zbuluar më shumë nga Perëndia dhe duke lejuar Shpirtin e Shenjtë të ndryshojë qëndrimet, mendimet, emocionet dhe veprimet e tyre për t'u bërë më shumë si Jezusi.

8. Organizatat dhe kishat që në këtë Ditë Ndërkombëtare të Gruas po ndihmojnë gratë të kapërcejnë

situata shumë të vështira si varfëria, papunësia, dhuna në familje, divorci dhe prostitucioni.

9. Gratë të zbulojnë se Perëndia u ka dhënë guxim të ndjekin rrugët e tij. "Sepse Perëndia nuk na ka dhënë frymë frike, por force, dashurie dhe urtësie." (2 Tim. 1: 7).

10. Burra të krishterë që respektojnë dhe nderojnë nënat, motrat, gratë, vajzat, të dashurat dhe koleget e tyre. Lutuni që ata të jenë një shembull pozitiv për burrat e tjerë në komunitetet e tyre

11. Ata që vizitojnë gratë dhe sigurojnë radio për ato që nuk kanë mundësi t'i blejnë. Lutuni që dëgjuesit të ftojnë të tjerë të bashkohen me ta në dëgjimin e Shpresë për ty dhe programeve të tjera të TWR në radio.

12. Gratë që përjetojnë shpresë nëpërmjet Jezusit. "Gëzohuni gjithnjë në Zotin Për çdo gjë falënderoni sepse i tillë është vullneti i Perëndisë në Krishtin Jezus për ju." (1 Thesalonikasve 5:18).

13. Gratë në shërbesë, duke kërkuar që Perëndia i Zotit tonë Jezu Krisht, Ati i lavdishëm, t'u japë atyre Frymën e diturisë dhe të zbulesës, në mënyrë që ato ta njohin më mire Atë (Efesianëve 1:17).

14. Gratë e braktisura që Perëndia t'u tregojë atyre që Ai i do dhe i pranon si bijat e tij të çmuara. "Vetë Fryma i dëshmon frymës sonë se ne jemi bij të Perëndisë." (Romakëve 8:16).

15. Klinikat dhe spitalet që ofrojnë kujdes shëndetësor për gratë, duke përfshirë operacionet për ato që vuajnë nga fistula ose mitra e shkarë (e rënë). Lutuni që radiodrama "Zëri i shërimit" të inkurajojë pacientet që vuajnë nga fistulat.

16. Gratë me paaftësi fizike të përjetojnë shpresë ndërsa i shërbejnë Perëndisë me gëzim. "Prandaj unë kënaqem në dobësi, në fyerje, në nevoja, në përndjekje, në ngushtica për shkak të Krishtit, sepse, kur jam i dobët, atëherë jam i fortë." (2 Korintasve 12:10).

17. Gratë e traumatizuara nga lufta për të përjetuar paqen që vetëm Perëndia mund të japë. "Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë po jua jap, po jo si e jep bota; zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë" (Gjoni 14:27).

18. Të burgosurat të dinë se Perëndia i do dhe dëshiron që ato ta ftojnë Krishtin në jetën e tyre. "sepse, po të rrëfesh me gojën tënde Zotin Jezus, dhe po të besosh në zemrën tënde se Perëndia e ngjalli prej së vdekurish, do të shpëtohesh." (Romakëve 10: 9).

19. Gratë që të kalojnë më shumë kohë duke u njohur me mendimet, karakterin dhe rrugët e Perëndisë duke studiuar Fjalën e tij.

20. Gratë të "gëzohen me shpresën e lavdisë së Perëndisë. Dhe jo vetëm kaq, por mburremi edhe në shtrëngimet, duke ditur që shtrëngimi prodhon këmbënguljen, këmbëngulja përvojën dhe përvoja shpresën." (Romakëve 5: 2-4).

21. Vajzat që marrin mesazhe kontradiktore se çfarë do të thotë të jesh grua. Disa nga këto mesazhe kërcënojnë shëndetin e tyre fizik dhe emocional.

22. Siguri dhe forcë për gratë që punojnë për të ndihmuar të tjerët të përmirësojnë jetën e tyre. "por ata që shpresojnë te Zoti fitojnë forca të reja, ngrihen me krahë si shqiponja, vrapojnë pa u lodhur dhe ecin pa u lodhur." (Isa 40:31).

23. Organizatat që ndihmojnë gratë dhe vajzat të shpëtojnë nga skllavëria seksuale dhe që ofrojnë shtëpi të sigurta, arsim dhe punësim.

24. Ata që ndihmojnë gratë shtatzëna të kuptojnë shkatërrimin e shkaktuar nga aborti, jo vetëm për foshnjat e tyre të palindura, por edhe atë fizik dhe emocional në jetën e tyre.

25. T'u bërë më shumë në përmirësimin e shëndetit të grave. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, rastet e malaries janë më pak në Paraguaj dhe Tanzani. Trakoma, e cila shkakton verbëri, është eliminuar në Gana.